



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVETKOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

KOMISIONI DISIPLINOR//DISCIPLINSKA KOMISIJA/ THE DISCIPLINARY COMMITTEE

**KD.nr.01/2019**

KOMISIONI DISIPLINOR, në përbërje nga gjyqtarët: Nenad Lazić, kryetar, Manushe Karaqi dhe Armend Berisha, anëtar të Komisionit, duke e shqyrtuar çështjen e përgjegjësisë disiplinore ndaj XXXX XXXXXXXXXÇ, gjyqtare në Gjykatën Themelore në xxx-Dega në xxxx, sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor ZPD-2018-210, i njëjti në procedurë të Komisioni Disiplinor ka marrë numrin KGJK/KD/01/2019, për pretendimin për neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështimin për të kryer apo abuzimin e funksioneve gjyqësore sipas nenit 34 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223) dhe shkelje të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtar, në seancën dëgjimore të mbajtur në prezencën e përfaqësuesit të ZPD-së, z.Kadri Begolli dhe gjyqtarës XXXX XXXXXXXXXÇ me datë 20.03.2019 merr këtë:

**V E N D I M**

XXXX XXXXXXXXXÇ, gjyqtare në Gjykatën Themelore në XXXXX- Dega në XXXXX, **nuk** është përgjegjëse për neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështimin për të kryer apo abuzimin e funksioneve gjyqësore sipas nenit 34 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223), siç është pretenduar në raportin përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor ZPD-2018-210.

**A r s y e t i m**

Në Komisionin Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovë Zyra e Prokurorit Disiplinor ka paraqitur Raportin Përfundimtar ZPD-2018-210 se bashku me shkresat e lëndës, më të cilin e ka ngarkuar XXXX XXXXXXXXXÇ, gjyqtare në Gjykatën Themelore në XXXXXX- Dega në XXXXXXXX, për neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështimin për të kryer apo abuzimin e funksioneve gjyqësore sipas nenit 34 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223).

Hetimin disiplinor Zyra e kishte filluar në bazë të dokumentit të paraqitur nga Kryetari i Gjykatës Themelore në XXXXXX, dokumenti me titull “Njoftim mbi gjetjet nga inspektimi i lëndëve kundërvajtëse në Degën në Kamenicë”, ky dokument mban shenjën e referencës të Gjykatës me numër Gj. A- Su. A 275/18 të datës 12 shtator 2018. Me këtë dokument kryetari e kishte informuar ZPD-në se ka formuar komision të veçantë për verifikim e pretendimeve për arritjen e afatit të parashkrimit relativ të një numër i caktuar i lëndëve me të cilat ishte e ngarkuar gjyqtarja XXXX XXXXXXXXXÇ. Pas verifikimit të pretendimeve nga komisioni, Kryetari i gjykatës e ka informuar dhe

ia ka përcjell në procedurë ZPD-së gjetjet e komisionit, se 343 lëndë të kundërvajtjeve janë përfshirë me parashkrim relative deri më datën 13 shtator 2018.

Në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor të mbajtur me datë 20.03.2019 përfaqësues i Zyrës së Prokurorit Disiplinor deklaroi që në bazë të provave të administruar nga ZPD, intervistës se vetë gjyqtarës, ka gjetur se në periudhë 10-mujore, gjyqtarja Xxxxxx Xxxxxxx, nga se paku 600 lëndë që i ka pasur në punë, ka lejuar arritjen e afatit të parashkrimit për 343 lëndë. ZPD konsiderohen se arritja e parashkrimit relativ të lëndëve të specifikuar në raport, ka ardhur si pasojë e neglizhencës së gjyqtarës lidhur me procedimin e lëndëve. I ka propozuar Komisionit që ti administroj provat dhe ti vlerësoj konform autorizimeve që i ka në vendimmarrje.

Gjyqtarja Xxxx Xxxxxx, në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor ka deklaruar se në sistemin gjyqësor është integruar me Marrëveshjen e Brukselit nga viti 2017, me dekret të Presidenti të Kosovës, si gjyqtare në Gjykatën Themelore në Xxxx –Dega në Xxxxxx. Ka filluar punën me 27-28 tetor, dhe një kohë ka shkuar në punë pa punuar në një lëmi të caktuar. Pas dy jave kryetari i degës së Gjykatës ka marrë vendim që të punoj në lëmin kundërvajtës. Ka theksuar se nga viti 1991 ka punuar vetëm në lëndët e kundërvajtjes. Në vazhdim ka deklaruar që lëndët e para të cilat i ka pranuar në punë, kanë qenë vetëm në gjuhën shqipe, e kjo është parë nga evidenca e shkrimes dhe datës 24 nëntor 2017. Nuk ka pasur procesmbajtës deri me dt.15.12.2017, një problem tjetër ka qenë fakti se nuk i ka pasur aktet sekondare në gjuhën serb dhe i është dashur ti marrë titujt nga gjuha shqipe dhe ti përkthejë të përkthyesit. I ka nxjerr vetë nga internet ligjet konkrete, dhe i është dashur kohë të familjarizohet me to, duke cekur njëkohësisht se gjatë tërë kohës me gjyqtarët e integruar sipas marrëveshjes së Brukselit është dashur ti ndjekim ligjëratë e obliguar. Në degën e Kamenicës ekziston vetëm një përkthyes, të cilit i duhet me qenë i pranishëm në çdo seancë, të përkthejë vendimet, të dhënat e lëndëve dhe se vetëm me një përkthyes ka qenë e pa mundur që ti kryejë të gjitha këto përkthime. Sipas gjyqtarës kjo ka qenë arsyeja që ka ardhur deri të parashkrimi i lëndëve dhe nuk ka pasur ndonjë qellim tjetër dhe nuk ka neglizhuar punën.

Sipas gjyqtarës, kanë qenë arsyet objektive pse ka ardhur deri të parashkrimi i këtyre lëndëve. Nga viti 2017 në vitin 2018 i janë transferuar gjithsej 1260 lëndë dhe me të gjitha problemet e lartë cekura i ka zgjedhur 758 lëndë. Ka theksuar se kanë shumë problem me gjetje të adresave të palëve e deri me përmbartimin e lëndëve, dhe ky problem i ka marrë shumë kohë. Mandej në vitin 2019 nuk ka arritur të bëhet asnjë një përmbartim dhe si pasojë e kësaj, rreth 110 lëndë kanë arritur parashkrimin relativ. Për pamundësinë e përfundimit të lëndëve në afat gjyqtarja Xxxxxx si problem ka theksuar edhe atë se ka pranuar lëndë nga ana e kolegeve të cilët kanë qenë pjesërisht të punuara. Për ballafaqimin më të gjitha këtë situatë, gjyqtarja vazhdimisht e kishte njoftuar mbikëqyrësin e degës së Xxxxxx. I ishte drejtuar edhe Gjykatës Xxxxxx për mendim juridike lidhur me këtë çështje se mundet të zëvendësohet dënimi me gjobë me dënim me burg. Kishte kërkuar edhe mbështetje për një bashkëpunëtor profesional dhe praktikant, por nuk ju ka mundur nga gjykata, për shkak të mungesës së stafit.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i ZPD-së deklaroi si pjesëtar i sistemit gjyqësor të Kosovës, të gjithë jemi të vetëdijshëm për rrethanat objektive të punës dhe se parashkrim nuk është hera e parë që po ndodh në këtë gjykatë dhe se ka ndodhur edhe te gjyqtarët e tjerë. Ka konstatuar se gjyqtarja nuk ka pasur për qëllim që të vijë deri të ky parashkrim gjatë kësaj periudhë 10- mujore. Mirëpo gjatë kësaj periudhë ka pasur mundësi që të ndërmer se pak një veprim procedural, që ky afat të shtyhet. Na realitet ka ndodhur e kundërta edhe pse gjyqtarja ka një përvojë se paku 30 vite si gjyqtare e kundërvajtjes. Ne të njëjtën kohë te gjitha lëndët që kanë qenë në punë tek gjyqtarët e lemisë se njëjtë janë zgjedhur, pra nuk është parashkruar asnjë lëndë. Andaj është kërkuar nga komisioni që raportin ta pranojë si të bazuar dhe gjyqtarës të ja shqiptoj një sanksioni konform shkeljeve të bëra.

Ndërsa gjyqtarja Xxxxxxxx në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga Komisioni që nëse ka përgjegjësi ligjorë është e gatshme ta pranoj, por ka theksuar që nuk ka qenë e pakujdesshme në punën e saj, është ballafaquar me shumë rrethana objektive dhe se ka qenë e pamundur edhe fizikisht na ana e saj që lëndët ti përfundon në afat ligjor.

Komisioni Disiplinor i ka administruar të gjitha provave në shkresat e lëndës, ka dëgjuar edhe deklarata e gjyqtarës të dhënë gjatë seancës dëgjimore, dhe pasi i ka shqyrtuar dhe analizuar konstatohet se gjyqtarja Xxxx Xxxxxxxx **nuk** është përgjegjës për neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështimin për të kryer apo abuzimin e funksioneve gjyqësore të pretenduara në raportin përfundimtar të ZPD-së.

Sipas vlerësimit të Komisionit nuk qëndron pretendimi i Zyrës se gjyqtarja ka qenë neglizhente në kryerjen e detyrave, dështimin për të kryer apo abuzimin e funksioneve gjyqësore. Xxxxxxxx Xxxxxxxx është integruar në sistemin gjyqësor të Kosovës në bazë të marrëveshjes se Brukselit nga viti 2017, dhe se nga kjo shihet se është një gjyqtare e re në këtë sistemi. E njëjta nuk e ka njohur legjislacionin e Kosovës dhe ju është dashur që gjatë punës të angazhohet edhe në njohjen e ligjeve konkrete, praktikave gjyqësore në Kosovë dhe ndjekje të trajnimeve të obliguara. Gjyqtarja kishte kërkuar edhe mbështetje administrative nga gjykata mirëpo nuk ju kishte afuar për shkak të mungesës së staff.

Duke patuar parasysh të gjitha këto, Komisioni vlerëson se në këtë rast gjyqtarja Xxxx Xxxxxxxx nuk është përgjegjës për neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështimin për të kryer apo abuzimin e funksioneve gjyqësore siç pretendon ZPD dhe nuk është përgjegjëse për ndonjë veprim konkret që do të rezultonte me shkelje të standardeve të sjelljeve profesionale për gjyqtarë.

Prandaj, nga këtu dhe nga arsyet e sipër theksuara, Komisioni ka konstatuar se Xxxxxx Xxxxxxxx **nuk** është përgjegjëse për neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështimin për të kryer apo abuzimin e funksioneve gjyqësore sipas nenit 34 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor te

Kosovës (Nr.03/L-223), si dhe nuk ka shkelur standardet e Kodit e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtar. Në seancën për këshillim dhe votim, njëzëri vendosi që XxxX XXXXXXXXĆ, gjyqtare në Gjykatën Themelore në xxxxx-Dega në xxxxxx të lirohet nga përgjegjësia disiplinore, prandaj vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR**  
**KD.nr.01/2019, datë 01.04.2019**

Kryetar i Komisionit Disiplinor  
Gjyqtari, Nenad Lazić

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në Prishtinë, brenda 15- ditësh nga dita e pranimi të Vendimit.

Vendimi t'u dërgohet:

- Skender Çoçaj, kryesues i KGJK-ës;
- Arianit Salihu, u.d drejtor, Zyra e Prokurorit Disiplinor;
- XxxX XXXXX, kryetar në Gjykatën Themelore në XxxX;
- XxxX XXXXXXXXĆ, gjyqtare në Gjykatën Themelore në XXXXX-Dega në XXXXX;
- Departamenti të Administratës dhe Personelit në SKGJK;